REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

**V E N D I M**

**Nr. 690, datë 18.11.2021**

**PËR**

**TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË KUÇOVË, PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE KUÇOVË, TË PASURIVE 6/570 DHE 6/571, ME VENDNDODHJE NË ZONËN KADASTRALE 2310**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 8, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Kuçovë, për njësinë administrative Kuçovë, të pasurive 6/570 dhe 6/571, me vendndodhje në zonën kadastrale 2310, sipas formularit gjithsej 1 (një) fletë dhe planeve të rilevimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, me qëllim implementimin e projektit "Rikualifikimi i Parkut Industrial Kuçovë".

2. Pasuritë e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, shtohen në listën e inventarit të pronave të paluajtshme publike të miratuar me vendimin nr.662, datë 8.10.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë së Kuçovës", të ndryshuar.

3. Bashkisë Kuçovë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit, t'i tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve pasuritë e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Bashkia Kuçovë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ARBEN AHMETAJ

# FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

**Bashkia Kuçovë**

Identifikoi: **Ledja Dailani** (Specialiste)
(emri, mbiemri pozicioni zyrtar)

Supervizoi: **Ferdinand Putro**
( Drejtor I Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi: **Kreshnik Hajdari ( Kryetar i Bashkisë Kuçovë)**
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)

FUSHA E PËRDORIMIT: lidhja 1 ( Transferim), prona për fushën e infrastrukturës, sportive dhe rekreative
(sheshe,lulishte,parqe dhe sherbime publike)

| Nr. Rend. | Zona Kadastr. & Indeksi i Hartës | Numri I Pasurise | Lloji i Pronës | Emri i Pronës Adresa | Sip. Tot e Pronës (m2) | Sip e Ndertesës (m2) | Funksioni për të cilin përdoret Prona | Institucioni / Enti me pergjegjësi administrative | Institucioni / Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit | Të dhëna të tjera (Shënime të veçanta) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 1 | 2310 G-4 | 6/570 | Truall | Llagja nr.2, Blloku "1 Maj" | 11300.8 | 2830 | Për zonë rekreative dhe hapësira të gjelbërta | Bashkia Kuçovë | Bashkia Kuçovë | |
| 2 | 2310 G-4 | 6/571 | Truall | Llagja nr.2, Blloku "1 Maj" | 609.2 | | Për zonë rekreative dhe hapësira të gjelbërta | Bashkia Kuçovë | Bashkia Kuçovë | |

ALL , SIP. PASURISE 11500.0m², SIP. BJQKMES SE NDERTIMIT- 2000m², NUMRI KATEVE , NUMRI I EMEV

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE




SH 1: 1000

| RIENTIMI | PERDORIMI | TIPI KUFIRIT | KUFITARI | ID/NIPT | SHENIME TE REALIZI |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | 6/571 ,179 ,138 | | |
| | | | 6/314 | | |
| | | | 6/135, 458 | | |
| | | | 6/145 | | |

TERROR:
KUCOVE
I:

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: O, D

Kode per teknologjine e matjeve: T-terren, Z-Zyre, O-Ortofoto, G-GPS, S-Stacion Total, D-Matje Distancash

PERCAKTIMI KUFIRIT: HK

Kode per percaktimin e kufirit: P-Perfaqesues i Pronareve, K-Kufitaret te gjithe, KP-Kufitaret Pjeserisht, PB-perfaqesues Bashkie, HK-Harta kadastrale

REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA KUCOVE

LL_, SIP. PASURISE 609.Zm², SIP. GJURMES SE NDERTIMIT= m², NUMRI KATEVE , NUMRI PE

## KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE




SH 1: 1000

| PERDORIMI | TIPI KUFIRIT | KUFITARI | ID/NIPT | SHENIME TE REALIZI |
|---|---|---|---|---|
| Rruge+Trotuar | Rruge+Trot | 6/134 | | |
| Sherbim+Banese | Ndertese | 6/176 | | |
| | Truall+Ndertese | 6/570 | | |
| | Truall+Ndertese | 6/570 | | |

TEROR. UCDVE

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: D, D

Kode per teknologjine e matjeve: T-terren, Z-Zyre, O-Ortofoto, G-GPS, S-Stacion Total, D-Matje Distancash

PERCAKTIMI KUFIRIT: HK

Kode per percaktimin e kufirit: P-Perfaqesues i Pronareve, K-Kufitaret te gjithe, KP-Kufitaret Pjeserisht, PB-perfaqesues Bashkie, HK-Harta kadastrale

NR.PROT. 5430/2
DATË 19.11. 2021

ZËVENDËSKRYEMINISTRIT
BASHKISË KUÇOVË
AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

**Sekretari i Përgjithshëm**

**Engjëll AGAÇI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - KËSHILLI I MINISTRAVE